

BE-ja DREJT KUSHTËZIMIT TË
ANËTARËSIMIT TË SERBISË NË BE

FAÇE 4-5

Bashkimi Evropian po punon për ta kushtëzuar anëtarësimin e Serbisë me

zbatimin e marrëveshjeve me Kosovën. Kushtëzimi i anëtarësimit, sipas analistëve

politikë, do të ketë efekt në kalkulimet politike të presidentit Vuçiq

ROMANI “ESKADRONËT E VDEKJES” I BARDHYL MAHMUTIT, QË PËRSHKRUAN GJENOCIDIN E SERBISË NDAJ SHQIPTARËVE, VLERËSOHET VEPRJA MË E MIRË NGA LSHK-ja F.3



AMBASADORI WALKER SHPALLET “QYTETAR NDERI” I VITISË, ZBULOHEK BUSTI I TIJ DHE I JEPET ÇELËSI I QYTETIT F.3

AKTUALE



HELIKOPTERËT E PARË USHTARAKË BLACK HAWK MBËRRIJNË NË SHQIPËRI F.2

MUSTAFA, KRITIKA VON CRAMONIT: NUK E DI A ËSHTË RAPORTUESE E LV-së APO E SHTETIT QË LV-ja SYNON TA SHNDËRROJË NË DIKTATURË F.5

QYTETARËT PROTESTOJNË KUNDËR MBYLLJES SË RRUGËS ‘XHORXH BUSH’ F.6

EKONOMI



ÇMIMET E KONSUMIT SHËNUAN RITJE PËR 4,9 PËR QIND NË VITIN QË LAMË PAS F.7

BANKA BOTËRORE: KOSOVA DO TA KETË RITJEN MË TË MADHE TË GDP-SË NË RAJON GJATË VITEVE 2024 DHE 2025 F.7

SPORT



FITORE E RËNDËSISHME PËR VËLLAZNIMIN, FITON EDHE BASHKIMI F.10

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kollegji
BIZNESI

www.kollegjibiznesi.com
info@kollegjibiznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Helikopterët e parë ushtarakë Black Hawk mbërrijnë në Shqipëri

TIRANË, 14 JANAR - Shtetet e Bashkuara ia kanë dorëzuar të shtunën vonë Shqipërisë porosinë e parë prej dy helikopterëve UH-60 Black Hawk, duke e cilësuar mbërritjen e helikopterëve ushtarakë amerikanë në Tiranë historike. Këta janë helikopterët e parë të këtij lloji të blerë nga Shqipëria në ShBA falë ndihmës së kësaj të fundit prej 50 milionë dollarëve.

Në një njoftim në “Facebook”, Ambasada Amerikane në Tiranë tha se helikopterët e rinj do të ndihmojnë në forcimin e

aftësive të Forcave Ajrore të Shqipërisë dhe aftësinë për të kryer evakuim mjekësor, rikuperim të personelit, misione kërkim-shpëtimi, si dhe mbështetje të lëvizjeve logjistike të NATO-s për operacione dhe stërvitje.

“Shtetet e Bashkuara janë krenare për partneritetin e fortë me Shqipërinë në fushën e mbrojtjes”, tha Ambasada Amerikane.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e cilësoi mbërritjen e këtyre helikopterëve si një investim “shumë të

rëndësishëm për sigurinë e vendit, në bashkëpunim me aleatin strategjik, ShBA-në”.

Ai theksoi në rrjetin social “Facebook” se ky investim ndikon drejtpërdrejt në rritjen dhe modernizimin e Forcave Ajrore të Shqipërisë.

Edhe ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Niko Peleshi, e quajti të rëndësishëm për vendin pajisjen me helikopterët dhe shprehu mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së. Ai shtoi se mbrojtja dhe siguria e vendit mbeten prioritetet “absolute”.



Frederik X bëhet mbret i Danimarkës, pasi Mbretëresha Margrethe abdikoi nga froni

KOPENHAGË, 14 JANAR - Frederik X u bë mbret i ri i Danimarkës të dielën, pasi nëna e tij, Mbretëresha Margrethe II, nënshkroi dorëheqjen edhe zyrtarisht pas plot 52 vjetëve në fron.

Margrethe, 83 vjeçe, e tronditi kombin natën e Vitit të Ri kur njoftoi se u bë monarkja e parë daneze në 900 vjetët e fundit që me vetëdëshirë heq dorë nga kurora.

Mijëra njerëz u mblodhën në rrugët e kryeqytetit danez të dielën për ta përshëndetur Frederikun dhe për t'i thënë lamtumirë Margrethes.

Frederik u bë edhe formalisht mbret pasi Margrethe e nënshkroi deklaratën e



abdikimit gjatë një takimi me Këshillin e Shtetit në Parlamentin danez të dielën në mëngjes.

Më vonë gjatë ditës, Frederik u shpall mbret nga kryeministri i

Danimarkës, Mette Frederiksen, në ballkonin e Parlamentit, me fjalët “Rroftë Mbreti Frederik 10”. “Shpresa ime është të bëhem mbret unifikues i së nesërme. Kjo

është një detyrë të cilën e marr me krenari, nder dhe kënaqësi”, tha Frederik në fjalimin e tij të parë pasi u bë mbret.

Atij iu bashkuan në ballkon edhe bashkëshortja e vet e lindur në Australia, Mary, e cila është mbretëreshë tani, si dhe fëmijët, Christian, i cili është trashëgimtar i fronit, Princesha Isabelle, dhe binjakët Princesha Josephine dhe Princi Vincent.

Më vonë, mbreti dhe mbretëresha e re parakaluan me karrocë nëpër rrugët e mbushura me njerëz në Kopenhagë për t'u kthyer në rezidencën e tyre, Amalienborg, kompleksin mbretëror të ndërtuar në vitet

1750, në qendër të Kopenhagës. Ata e morën fronin në një kohë kur monarkia daneze po gëzon mbështetje të madhe publike.

Në sondazhin e fundit të bërë pasi Margrethe njoftoi se do të hiqte dorë nga froni, 82 për qind e danezëve thanë se presin që Frederik të jetë i mirë apo shumë i mirë në rolin e tij, derisa 86 për qind e thanë të njëjtën për Maryn.

Margrethe, e cila në të kaluarën kishte thënë se do ta mbante fronin përjetë, nuk ka treguar arsyet e vendimit për të hequr dorë, por tha se një operacion në shpinë që i ishte nënshtruar vitin e kaluar e kishte bërë ta mendonte të ardhmen.

Shpërthen një vullkan në Islandë, lëshon lavë drejt një vendbanimi

GRINDAVIK, 14 JANAR - Një vullkan ka shpërthyer në jugperëndim të Islandës për herë të dytë brenda më pak se një muaji, duke lëshuar lavë në drejtim të një vendbanimi të afërt.

Shpërthimi, pak para orës 8:00 të mëngjesit të dielën, ndodhi pas një sërë tërmetesh në afërsi të qytetit Grindavik, njoftoi Zyra Meteorologjike e Islandës.

Banorët e këtij vendi u evakuuan gjatë natës, raportoi televizioni islandez RUV. “Lava po rrjedh disa qindra metra në veri të vendit, pra 400 deri në 500 metra”, tha Kristin Jonsdottir nga Zyra Meteorologjike e Islandës për televizionin RUV.

“Lava po rrjedh drejt Grindvikut”, shtoi ai.

Banorët e Grindvikut ishin



evakuuar nga shtëpitë e tyre edhe në nëntorin e kaluar dhe nuk ishin kthyer në qytet për gjashtë javë pas një sërë tërmetesh dhe shpërthimit të një vullkani si pasojë e tyre.

Ata u kthyen më 22 dhjetor. Qyteti me 3 800 banorë afër

aeroportit kryesor të Islandës u evakuua më 10 nëntor kur një sërë tërmetesh shkaktuan çarje të tokës mes Grindavikut dhe Sylingarfellit, një qytet i vogël bjeshkor në veri.

Pre atëherë janë ndërtuar mure mbrojtëse përreth vullkanit me



shpresën e devijimit të magmës larg vendbanimit. Por, muret e ndërtuara në veri të Grindavikut janë rrëzuar dhe lava po lëviz në drejtim të qytetit, tha zyra meteorologjike.

Në Islandë ndodh shpërthimi i një vullkani çdo katër-pesë vjet

mesatarisht. Më 2010 ndodhi shpërthimi i vullkanit Eyjafjallajokull, më i madhi në vitet e fundit, duke lëshuar re të mëdha hiri në atmosferë, gjë që shkaktoi mbylljen e hapësirave ajrore nëpër Evropë.

Romani “Eskadronët e vdekjes” i Bardhyl Mahmutit, që përshkruan gjenocidin e Serbisë ndaj shqiptarëve, vlerësohet vepra më e mirë nga LShK-ja

PRISHTINË, 14 JANAR - Romani “Eskadronët e vdekjes” i autorit Bardhyl Mahmuti është vlerësuar vepra më e mirë nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës e që pasqyron gjenocidin serb ndaj shqiptarëve. Kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, Shyqri Galica, tha se vepra “Eskadronët e vdekjes” e autorit Bardhyl Mahmuti është e veçantë edhe si krijim letrar dhe artistik edhe si histori. “Është i veçantë në të vërtetë... Pavarësisht nga ndihma që pretendon autori ta ketë pasur nga shumë vetë, prirja e tij në aspektin stilistik letrar, performues, historik është fakt që tregon jo vetëm për përkushtimin e shkrimtarit, por talentin për të artikuluar me një gjuhë të pasur, me një mendim të mbrehtë e me një kërkesë të sofistikuar për ndriçimin e barbarisë serbe. Shkrimtari Bardhyl Mahmuti është autori që ka depërtuar në thellësitë epokale të shpirtit shfarosës të pushtuesit serb duke dhënë

romanin më të denjë dhe më të mirë pothuajse deri sot për temën e gjenocidit”, tha Galica. Për veprën “Eskadronët e vdekjes”, kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës i dorëzoi mirënjohje shkrimtarit Bardhyl Mahmuti. Autori i librit ka potencuar se kjo mirënjohje nderon jo vetëm atë, por gjithë të tjerët që janë përkushtuar të hedhin dritë mbi një krim, siç e quajti ai, aq monstruoz e që ka rrezik të mbetet në heshtje.



Më tutje, ai theksoi se dhënia e mirënjohjes nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës i jep një shtytje të fuqishme të shpërndarjes së romanit, derisa shtoi se kjo do të ndikojë që të tjerët të mund të shohin edhe një të vërtetë. “...Libri ‘Eskadronët e vdekjes’, sado modeste të duket që kanë kontribuar të tjerët, falë rrëfimeve që m’i kanë dhënë qoftë Bajrush, Sadiku, apo Vllaznimi, sepse personazhet kryesore në roman janë personazhe reale, janë



pikërisht personazhet që i kanë dhënë një shtytje e sot më thërrasin prej Italisë se kush është Sadiku... Dhënia e mirënjohjes nga Lidhja e Shkrimtarëve i jep një shtytje të fuqishme shpërndarjes së romanit jo për shkak të Bardhyl Mahmutit, por sepse duke lexuar qoftë në italisht, anglisht apo në të gjitha gjuhët e tjera, do të kenë mundësi të shohin edhe një të vërtetë nga këndvështrimi ynë”, theksoi

Mahmuti. Libri “Eskadronët e vdekjes” është botuar nga Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur”. Romani i autorit Bardhyl Mahmuti është i bazuar në ngjarje të vërteta dhe është botuar në shënim të Ditës së Gjenocidit në Kosovë, më 15 janar 2021. Kjo vepër ka pasur disa botime në shqip, kurse është përkthyer dhe po përkthehet edhe në disa gjuhë të huaja.

Walker takohet me Kurtin, ndihet i lumtur dhe krenar për atë që Kosova ka arritur



PRISHTINË, 14 JANAR - Në prag të 25-vjetorit të masakrës së Reçakut, kryeministri Albin Kurti ka pritur në një takim miqësor ambasadorin William Walker. Kurti e ka falënderuar për kontributin e pazëvendësueshëm gjatë kohës së luftës dhe jehonën që i ka dhënë masakrës së Reçakut në rrafshin ndërkombëtar, duke përshkruar ndodhinë në Reçak si masakër dhe krim kundër njerëzimit. Qeveria ka njoftuar se Kurti dhe

Walker rikujtuan vitet 1998 dhe 1999, kur ambasadori William Walker ishte në Kosovë në krye të Misionit Verifikues të OSBE-së, që kishte për mision të verifikonte nëse forcat serbe po vepronin në përputhje me marrëveshjen e tetorit të Kombeve të Bashkuara për t'i tërhequr forcat e armatosura dhe për ta respektuar armëpushimin. Ambasadori Walker tha se ndihet i lumtur dhe krenar për atë që Kosova ka arritur në një periudhë

të shkurtër kohore, duke u bërë një nga shtetet më demokratike në Evropë. Ai tha se sa herë që vjen në Kosovë u gëzohet ndryshimeve që i sheh teksa lëviz nëpër rrugët e Kosovës. Bashkë me urimet për jetë të gjatë dhe shëndet të mirë, kryeministri Kurti ritheksoi mirënjohjen ndaj ambasadorit Walker, për rolin e tij korrekt, konkret dhe aq human të treguar në raport me krimet e luftës që Serbia ka kryer ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Testimi i mësimdhënësve nuk është obligues, fillon si testim për avancim

PRISHTINË, 14 JANAR - Testimi i mësimdhënësve në Kosovë këtë vit nuk do të jetë obligues. Këtë e ka bërë me dije ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci. Në dy fazat e para do të fillohet si një testim për avancim në karrierë për përfitimin e licencës së avancuar, teksa hapi i radhës do të



jetë për mësimdhënësit të cilët do të hyjnë në proces dhe pastaj me kohë do të jepen informatat

për të gjitha çështjet e tjera. Për këtë ide të Nagavcit, SBASHK-u thotë se nuk është i informuar, derisa ka mësimdhënës që e vlerësojnë të mirëseardhur procesin, por edhe të atillë që e vlerësojnë të pakuptueshëm. Zarife Bajgora Godanci, e cila

është mësimdhënëse në shkollën “Emin Duraku” në Prishtinë, e vlerëson të mirëseardhur procesin e vlerësimit të mësimdhënësve. Por kështu nuk mendon edhe kolegja e saj Lindita Fazliu. Ajo e konsideron të pakuptueshme pse duhet të testohen.

Kundërshtim për testim ka edhe nga Sindikata e Arsimit, e cila ka deklaruar se parimisht është kundër testimit me shkrim të njohurive të punëtorëve të arsimit përderisa janë për vlerësim të punës së mësimdhënësve përmes inspektorëve profesionalë.

Sot ndizen qirinj për viktimat e gjenocidit në Kosovë

PRISHTINË, 14 MARS - Me rastin e Ditës së Përkujtimit të Gjenocidit në Kosovë, Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur” u ka bërë thirrje qytetarëve që më 15 janar 2024, duke filluar nga ora 19:30, të bëjnë ndezjen e qirinjeve në shenjë përkujtimi për viktimat e gjenocidit në

Kosovë. “Ju ftojmë që deri më 15 janar të vendosni këtë lulëkuqe si fotografi të profilin tuaj. Ftoni edhe miqtë tuaj ta bëjnë këtë gjë. 15 janari - dita e përkujtimit të gjenocidit ndaj shqiptarëve në Kosovë. 1999 -2024: një çerek shekulli i gjenocidit ndaj shqiptarëve në Kosovë.

Ne nuk harrojmë! Lulëkuqja me katër petale, simbol i gjenocidit në Kosovë: Katër petalet e lulëkuqes paraqesin katër format e veprimeve të gjenocidit që u zbatuan në Kosovë: vrasjet, dhunimet seksuale, spastrimi etnik dhe shkatërrimi i objekteve që lidhen me përkatësinë etnike

dhe identitetin shqiptar. Ndërsa në vend të kokrrave të zeza të lulëkuqes, në logo janë prezantuar figura burrash, grash, djemsh dhe vajzash për të përfshirë të gjitha kategoritë e shqiptarëve që ishin shndërruar në objekt shkatërrimi nga politika e



gjenocidit të Serbisë”, është thënë në njoftimin e kësaj qendre.



BE-ja drejt kushtëzimit të anëtarësimit të Serbisë në BE

Bashkimi Evropian po punon për ta kushtëzuar anëtarësimin e Serbisë me zbatimin e marrëveshjeve me Kosovën. Kushtëzimi i anëtarësimit do të ketë efekt në kalkulimet politike të presidentit Vuçiq, sipas analistëve politikë

PRISHTINË, 14 JANAR - Në mesin e kushteve detyruese për Serbinë për anëtarësim në Bashkimin Evropian pritet të përfshihet edhe zbatimi i marrëveshjeve që Serbia i ka arritur deri tani me Kosovën në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. Për këtë është duke punuar Komisioni Evropian dhe Shërbimi i Veprimit të Jashtëm i BE-së (EEAS) për ta ndryshuar kornizën e bisedimeve në kapitullin e 35 me Serbinë për anëtarësim. “Puna në këtë drejtim po vazhdon në përputhje me kërkesën e vendeve anëtare”, tha zëdhënësi i BE-së, Peter Stano. Kërkesa për ndryshim të kushteve në kapitullin 35 u bë nga shtetet

anëtare të BE-së, pasi Serbia zyrtarisht përmes kryeministres së saj, Ana Brnabiq, tha se “vendi i saj nuk do t’i zbatonte të gjitha marrëveshjet për të cilat u pajtua me Kosovën”.

Kurti: Serbia nuk respekton marrëveshjen për normalizimin

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pas një mbledhje të qeverisë, e akuzoi Serbinë se nuk po e respekton Marrëveshjen për normalizim të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. “Neni një i marrëveshjes thotë që palët, pra Kosova dhe Serbia, do të zhvillojnë marrëdhënie të mira fqinjësore me njëra-tjetrën bazuar në të drejtat e barabarta. Serbia, megjithatë, zgjedh gjithçka mbi zhvillimin e marrëdhënieve të mira me ne. Ajo në të vërtetë zgjedh ta sulmojë Kosovën, siç bëri më 24 shtator 2023 në Banjskë, pastaj t’i mbrojë kryerësit e kësaj vepre në krye me Millan Radoiçiqin”, tha Kurti. Ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoiçiq, e mori përgjegjësinë për kryerjen e sulmit ndaj Policisë së Kosovës më 4 shtator të vitit të shkuar nga një grup serbësh të armatosur. Kosova dhe Serbia

vitin e shkuar arritën një marrëveshje për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve dhe Aneksin për zbatimin e saj, e njohur si marrëveshja e Ohrit. Këtë BE-ja do ta bëjë “ligjërish të detyrueshme”, ndonëse palët u pajtuan për marrëveshjen, por nuk vendosën firmat. Në tetor të vitit të shkuar udhëheqësit e Gjermanisë, kancelari Scholz, presidenti i Francës, Macron, kryeministrja e Italisë, Meloni dhe përfaqësues të institucioneve të Bashkimit Evropian, i kërkuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, që ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, ndërsa presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ta njohë de facto Kosovën.

Vuçiq: Na kërkohet njohja e pavarësisë së Kosovës

Ditë më parë këtë e rikujtoi vetë presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i cili tha se “Evropa po i kërkon Serbisë ta njohë pavarësinë e Kosovës”. “De facto ose de jure, kjo po kërkohet. Le të mos gënjejmë për këtë gjë. Fuqia më e madhe, Bashkimi Evropian, po e kërkon këtë”, tha Vuçiq për mediet në Serbi. Kryeministri i Kosovës, Albin

Kurti, tha se “Asociacioni nuk është top prioritet i normalizimit. Është marrëveshja bazike. Andaj të gjithë kolegët e mi, jo vetëm në Kosovë, i lus që të mos e nxjerrin nga paketa draft-statutin ose Asociacionin si një çështje”, tha Kurti, duke shtuar se “nga 11 nenet e Marrëveshjes Bazike, së paku tetë janë shkelur nga Serbia”, prandaj ai kërkoi reagim nga Bashkimi Evropian. “Ne kërkojmë siguri ligjore jo vetëm për zbatim të marrëveshjes, por edhe për respektim dhe mosshkelje të saj. Kjo është arsyeja kryesore pse kemi kërkuar të ketë nënshkrim të marrëveshjes”, tha Kurti. Pas kësaj deklarate të Kurtit, i menjëhershëm ishte reagimi i drejtorit të Zyrës për Kosovën në qeverinë serbe, Petar Petkoviç, i cili e akuzoi kryeministrin e Kosovës për, siç tha, “shkelje të marrëveshjeve në Bruksel”, veçmas atë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. “Kurti as nuk mund ta rishkruajë marrëveshjen e nënshkruar në Bruksel 11 vjet më parë, zbatimi i së cilës garantohet nga Bashkimi Evropian, as nuk mund të shkruajë apo të flasë asnjë fjalë pa sulmuar Beogradin dhe serbët në Kosovë, sepse kjo është e vetmja gjë që ai di të bëjë”, tha Petkoviç. Sipas tij, Albin Kurti është

“burimi kryesor” i jostabilitetit në Ballkanin Perëndimor. Ndryshim të qasjes perëndimore ndaj Serbisë kërkoi edhe ministri i Jashtëm britanik David Cameron, menjëherë sapo u kthye nga një vizitë që zhvilloi më 04.01.2024 në Kosovë. Cameron tha se “duhet të shprehet zhgënjim me sjelljen e Qeverisë së Serbisë pas ngjarjeve të shtatorit në Banjskë të Zveçanit”, ku një grup serbësh të armatosur vranë një polic të Kosovës. Autoritetet e Kosovës fajësuan Serbinë për përfshirje në sulm, por Beogradi e mohoi këtë. “Jam i vetëdijshëm se sa e rrezikshme ishte, prandaj ishte një prej arsyeve që shkova në Kosovë”, tha Cameron. Ai tha se “është koha të ndryshohet qëndrimi i Perëndimit ndaj Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor, duke paralajmëruar se Rusia po synon ta destabilizojë këtë rajon”. Por si e shohin analistët politik nismën e Shërbimit të Veprimit të Jashtëm të BE-së, i cili ka kërkuar që marrëveshja e Ohrit për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi të bëhet pjesë përbërëse e kapitullit 35 për Serbinë në negociatat për anëtarësim në BE. Demush Shasha nga Instituti Epik i tha DW-së se “patjetër ky kushtëzim ndikon në kalkulimin politik të presidentit Vuçiq, pasi

Mustafa, kritika von Cramonit: Nuk e di a është raportuese e LV-së apo e shtetit që LV-ja synon ta shndërrojë në diktaturë

PRISHTINË, 14 JANAR - Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka reaguar pas takimit që ka pasur kryeministri Albin Kurti me raportuesen për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon. Mustafa ka bërë disa kritika ndaj Viola von Cramon, duke thënë se ajo ka dhënë kontribut që Lëvizja Vetëvendosja të vijë në pushtet. “Po harrojnë ta falënderojnë raportuesen për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, për kontributin e jashtëzakonshëm të saj për ardhjen e LV-së në pushtet. Jashtë çdo norme normale, me subjektivizëm të pashoq, me përzierje flagrante në relacionet e brendshme partiake dhe demokratike e me anim të hapur, Cramoni e mbajti lart flamurin e Vetëvendosjes, duke atakuar para zgjedhjeve partitë që sot janë në opozitë. Sot nuk e di a është raportuese e LV-së apo e shtetit që LV-ja synon çdo ditë ta shndërrojë në diktaturë?!” ka shkruar Mustafa në “Facebook”.



Ambasadori Walker shpallet “Qytetar Nderi” i Vitisë, zbulohet busti i tij e i jepet çelësi i qytetit

VITI, 14 JANAR - Kuvendi Komunal i Vitisë, me nismën e kryetarit të komunës, Sokol Haliti, e ka shpallur “Qytetar Nderi” ish-ambasadorin e OSBE-së dhe diplomatin amerikan William Walker. Ky titull iu dha atij në një seancë të jashtëzakonshme të

Kuvendit Komunal të Vitisë. Gjithashtu, u bë edhe zbulimi i bustit të Walkerit dhe iu dha atij edhe çelësi i qytetit. Me këtë rast kryetari Haliti ka folur edhe për kontributin dhe personalitetin e Walkerit. “Ambasadori William Walker është një figurë e shquar që ka

lënë një ndikim thelbësor në zhvillimet dhe transformimet në Kosovë gjatë periudhës së tij të shërbimit. Me një karrierë të pasur diplomatike dhe një përkushtim të veçantë ndaj çështjeve të Ballkanit dhe të drejtave të njeriut, ambasadori Walker ka qenë një udhëheqës

i shquar dhe një ndihmës i palodhur në rrugën drejt paqes dhe stabilitetit në këtë rajon të ndërlikuar”, u shpreh kryetari Haliti. Kurse ambasadori Wiliam Walker tha se ndihet i nderuar për respektin që i bëhet në Kosovë, duke potencuar se ai

viziton Kosovën çdo vit, në veçanti Reçakun dhe kompleksin e familjes Jashari. Ai shtoi se Kosova ka arritur një përparim të madh të zhvillimit në një kohë të shkurtër. Walker tha se vjen në Kosovë pasi që është i dashuruar në këtë vend.



si në kuptimin politik, por edhe në kuptimin ekonomik, është tejet e rëndësishme që Serbia të perceptohet si një vend, i cili ngelet në kursin e saj drejt anëtarësimit në BE”. “Ky kushtëzim do të varet edhe nga perceptimi i Vuçiqit për vullnetin e BE-së për pranimin e Serbisë në BE. Nëse ai vëren se BE-ja, pa marrë parasysh çfarë bën Serbia, nuk do t’i hapë dyert në një afat të shkurtër për anëtarësimin e Serbisë, atëherë iniciativa e Vuçiqit për të bërë

kompromise karshi dialogut do të zbehet”, tha Shasha.

Kursi i Serbisë, zgjedhjet në ShBA dhe lufta në Ukrainë

Kursin e politikës së Vuçiqit, Shasha e ndërlidh edhe me vitin zgjedhor në ShBA dhe dinamikën e luftës në Ukrainë. Sipas tij, “pasojat e këtyre dy zhvillimeve do të ndihen edhe në rajonin e Ballkanit”. Në një

skenar ku president i ardhshëm i ShBA-së mund të zgjidhet Donald Trump dhe rrjedhimisht një skenar ku pozita e Ruisë forcohet në Ukrainë, atëherë Vuçiqi patjetër se do të jetë në një pozitë shumë më të konsoliduar për ta rinegociuar pozitën e Serbisë dhe kushtëzimet respektive në kuadër të dialogut”. Drejtori i Institutit Epik, Demush Shasha, thotë se “kjo është edhe arsyeja përse Vuçiqi

është duke bërë çdo gjë për të ruajtur status-quonë në kuadër të dialogut përmes episodeve si ‘më dhemb dora e djathtë’ për t’i nënshkruar marrëveshjet e dialogut, apo episodi i Banjskës. Të dyja këto episode kanë qenë pjesë e së njëjtës strategji dhe të njëjtët qëllim: ngadalësimi i dialogut dhe blerja e kohës duke ruajtur status-quon me shpresën e ardhjes së rrethanave më të favorshme gjeopolitike për Serbinë”. Prandaj, sipas tij, kushtëzimi i

Serbisë në kuadër kapitullit 35 do t’i ankorojë obligimet e dialogut për njohjen e elementeve të shtetësisë së Kosovës, ashtu siç tashmë kanë kërkuar edhe liderët më të fuqishëm evropianë. “Në kuadër të procesit formal të anëtarësimit të Serbisë në BE, shumë do të varet edhe nga vendosmëria e BE-së për t’i anëtarësuar vendet e rajonit në BE në një afat të parashikueshëm kohor”, shprehet Demush Shasha.

Antidroga, aksion në Prishtinë, arrestohen disa të dyshuar dhe sekuestrohet sasi e drogës dhe dëshmi të tjera



Prishtinë, 14 janar - Policia e Kosovës, konkretisht hetues policorë të antidrogës nga Njësia e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve, rajoni i Prishtinës, pas një hetimi disamujor në rastin e koduar “Golfi”, në drejtim të veprës penale shitblerje të substancave narkotike, më 13 janar rreth orës 19:00, në bashkëpunim edhe me njësitë e tjera rajonale, kanë realizuar një operacion policor në qytetin e Prishtinës. Fillimisht në rrugën “Ernest Koliqi” në Prishtinë është ndaluar vetura e tipit BMW, ngjyrë e bardhë, me targa

vendore, të cilën e drejtonte i dyshuari kryesor me initiale (Y. A.), 1997. Gjatë kontrollit të tij në trup i janë gjetur para të gatshme (1 100.00 euro) dhe tre (3) telefona (Iphone). Të njëjtën kohë njësitet policore kanë zbarkuar në rrugën “Jeronim Derada” te shtëpia e të dyshuarit të lartcekur me initiale (Y. A.) dhe në momentin e arritjes te shtëpia, aty afër derës së oborrit, ndodheshin dy persona të tjerë (U. G.) 1999 dhe (F. Sh.) 1999, ndërsa me të hyrë brenda oborrit një tjetër i dyshuar me initiale (F. H.) 1998 ka filluar të ikë nga vendi i ngjarjes dhe ka hedhur në

oborrin e shtëpisë së fqinjit një qese të mbushur me substancë të dyshuar narkotike e cila më vonë, pas matjes, ka rezultuar me peshë (266 gramë). Hetuesit e antidrogës, pas disa metrave ndjekje, kanë arritur ta ndalojnë dhe arrestojnë të dyshuarin e lartcekur me initiale (F. H.) 1998, ku gjatë kontrollit të tij është gjetur një sprej me mbishkrimin “NATO”, një telefon (Iphon) dhe 120 euro para. Gjatë realizimit të operacionit të bastisjes dhe kontrollimit të shtëpisë së të dyshuarit (Y. A.) janë gjetur dhe sekuestruar prova dhe dëshmi të tjera.

Lëndohen 15 persona nga shpërthimi i një bombole gazi në një shtëpi në Mitrovicë

PRISHTINË, 14 JANAR - Pesëmbëdhjetë persona janë lënduar të shtunën pasdite si pasojë e shpërthimit të një bombole gazi në një fshat të Mitrovicës, rreth 40 kilometra larg kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës, ka njoftuar Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK). “Katërmëdhjetë pacientët që kanë pësuar lëndime nga djegiet, nga bombola e gazit dhe 1 me lëndime në gjoks, në fshatin Këq të Mitrovicës, pas trajtimit në Klinikën Emergjente të QKUK-së, janë transferuar për mjekim të mëtutjeshëm në klinika të ndryshme të QKUK-së. Katër nga ta janë operuar në sallat emergjente, kurse tek të tjerët janë kryer ndërhyrje në sallën e vogël të ndërhyrjeve kirurgjike, Shërbimin e Reanimimit dhe atë Kirurgjik të po kësaj klinike. 4 pacientë janë transferuar për mjekim të mëtejshëm në Mjekimin Intensiv Qendror, meqë kanë gjendje më të rënduar shëndetësore nga djegia. 8 pacientë janë transferuar në Klinikën e

Kirurgjisë Plastike, ku po e vazhdojnë trajtimin dhe mbikëqyrjen nga stafi shëndetësorë. 2 në Kirurgjinë Abdominale dhe 1 do të transferohet në Kirurgjinë Torkale”, ka njoftuar ShSKUK-ja, duke bërë me dije se stafi mjekësor dhe infermierët e këtyre klinikave do të vazhdojnë të ofrojnë kujdes dhe mbikëqyrje shëndetësore 24-orëshe për këta pacientë. Ndërkaq një vajzë dhjetëvjeçare që ka pësuar lëndime të dielën është nisur për shërim në Suedi. Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka njoftuar se komuna do të ndajë një shumë prej 20 000 eurosh për ta ndihmuar familjen Brahimi, e prekur nga shpërthimi i bombolës së gazit natën e kaluar. “Të dashur qytetarë, me qëllim që t’i dalim në ndihmë familjes Brahimi, e prekur nga shpërthimi natën e kaluar, komuna e Mitrovicës do të marrë vendim për ndarjen e 20 000 eurove. Edhe njëherë uroj shërim të shpejtë për të lënduarit!”, ka njoftuar Hamza në “Facebook”.



Qytetarët protestojnë kundër mbylljes së rrugës “Xhorxh Bush”



PRISHTINË, 14 JANAR - Dhjetëra qytetarë i janë përgjigjur thirrjes për protestë të dielën nga “Vrojtuesit e Lagjes në Prishtinë”, me kërkesë që rruga “Xhorxh Bush” në kryeqytet të lirohet për qarkullimin e veturave. Protestuesit theksuan se bllokimi i kësaj rruge kryesore ka shkaktuar kaos nëpër rrugët e tjera në kryeqytet. Qytetarët kërkuar edhe që kryetari Përparim Rama t’i

pranojë ata në takim për të diskutuar për kërkesat e tyre. Fatmir Muçolli, një prej protestuesve, shprehu pakënaqësitë në emër të protestuesve. “Pse nuk është dikush i pranishëm këtu nga komuna e Prishtinës? Pse nuk është këtu dikush i pranishëm nga Ministria e Infrastrukturës?”, ka pyetur Muçolli. Ramize Curri, banore e Prishtinës, tha se kryetari i

komunës, Përparim Rama, duhet t’i pyesë qytetarët për këtë vendim, sepse qyteti nuk është vetëm i kryetarit. “Kryeqyteti i Prishtinës është i krejt qytetarëve të Prishtinës, nuk është vetëm i Përparim Ramës. Le ta dijë Përparim Rama se për këtë qytet edhe ne paguajmë tatime. Qytetarët nuk hanë bar. Le t’i pyesë qytetarët a janë të kënaqur me këtë vendim”, ka theksuar Curri, raporton EO.

Çmimet e konsumit shënuan rritje për 4,9 për qind në vitin që lamë pas

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 JANAR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin dhjetor 2023. Sipas raportit, indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 4.9-përqindësh në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

“Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit në vend në vitin 2023 ishte më i lartë në një mesatare prej (4,9-përqindësh) krahasuar me vitin 2022”, ka njoftuar ASK-ja.

Ngritja e indeksit të çmimeve të konsumit është vërejtur te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: perimet (15,9 për qind), pemët (11,4 për qind), prodhimet ushqimore (11,3 për qind), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (11,2 për qind), buka dhe drithërat (8,9 për qind), qumështi, djathi dhe vezët (8,4 për qind), mishi (7,8 për qind), energjia elektrike, gazi dhe lëndët djegëse të tjera (7,5 për qind), mobilie, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtja e shtëpisë (7,3 për qind), strehimi, uji, (6,4 për qind), pijet alkoolike, duhani (6,4 për qind), pijet joalkoolike (6,3 për qind), restaurantet dhe hotelet (5,8 për qind), mallra

dhe shërbime të ndryshme (3,8 për qind), blerja e automjeteve (3,8 për qind), veshje dhe këpucë (3,4 për qind), shëndetësia (2,7 për qind) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 6,2 përqindja në IHÇK.

Ndërsa rënie e indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit gjatë vitit 2023 është vërejtur te nëngrupet e COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-11,4 për qind), përdorimi i pajisjeve të transportit personal (-8,3 për qind), transporti (-2,2 për qind) me një ndikim të përbashkët prej -1,3-përqindësh në IHÇK.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej (2,3-përqindësh) në muajin dhjetor 2023 krahasuar me muajin dhjetor 2022. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pemët (16,6 për qind), perimet (16,4 për qind), pajisje terapeutike (6,9 për qind), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (6,6 për qind), pijet alkoolike, duhani (6,5 për qind), mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve personale të transportit (6,5 për qind), prodhimet ushqimore (6,3 për qind), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (5,8 për qind),



restaurantet dhe hotelet (3,9 për qind), produktet mjekësore, aparaturat dhe pajisjet (3,6 për qind), shërbimet ambulatorë (3,4 për qind), buka dhe drithërat (2,4 për qind), mallrat dhe shërbimet e ndryshme (2,4 për qind), veshje dhe këpucë (2 për qind), gazi (2 për qind), shërbimet financiare (1,8 për qind), mishi (1,3 për qind), mobilie dhe orendi - qilima dhe mbulesa të tjera dysHEMEJE (1,1 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2,7-përqindësh në IHÇK.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: vajrat dhe yndyrat (-10,5 për qind),

qumështi, djathi dhe vezët (-3,7 për qind), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj (-0,9 për qind), mjetet e komunikimit (-0,4 për qind) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,4-përqindësh në IHÇK.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare 0,3 për qind në muajin dhjetor 2023 krahasuar me muajin nëntor 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të artikujve dhe shërbimeve te grupet dhe nëngrupet e COICOP-i:

shërbimet për transport (16,7 për qind), energjia elektrike (10,3 për qind), perimet (2,6 për

qind), duhani (1,7 për qind), qumështi, djathi dhe vezët (1,7 për qind), pajisjet shtëpiake (0,4 për qind), pijet joalkoolike (0,2 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,9-përqindësh në IHÇK.

Ndërsa rënia e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-6,0 për qind), buka dhe drithërat (-0,8 për qind), shëndetësia (-0,2 për qind), veshje dhe këpucë (-0,1 për qind) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,6-përqindësh në IHÇK.

Tahiri: Kosova, vendi me pagat më të ulëta e me çmimet më të larta të energjisë



PRISHTINË, 14 JANAR - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, derisa ka shtruar pyetjen se “për çfarë qeverisje të mirë po flasim”, ka thënë se Kosova është vendi me pagat më të ulëta e me çmimet më të larta të rrymës.

Tahiri ka përmendur edhe disa çështje të tjera: “Vendi me pensione të nivelit të asistencës sociale; Vendi me pagën minimale më të ulët (170) euro në rajon, e që nuk ka fuqi punëmarrëse në treg; Vendi ku investimet kapitale prej buxhetit të shtetit me rreth 60 për qind janë orientuar në 4 komuna të partisë në pushtet, të cilat mbulojnë vetëm 15për qind të territorit dhe 12për qind të popullsisë; Vendi i vetëm në

rajon ku qytetarët ende nuk kanë sigurim shëndetësor; Ku niveli i arritshmërisë sipas PISA është më i ulët në rajon; Ku nuk është realizuar asnjë projekt dhe investim i huaj strategjik; Ku lidershipi shpenzon tri vite vendnumëro në rrafshin ndërkombëtar dhe në dialog, e kauzë politike e ka pasur platformën ‘Jo-Negociata’; Ku sanksionet dhe heqja e vizave janë ende kryefjala në qeveri; Ku nuk ka asnjë ligj vital, i cili nuk synon rrëzimin e ndarjes së pushteteve, politizimin, dhe shkeljen e të drejtave fundamentale, e për rrjedhojë bien të gjitha në vlerësimin kushtetues”, ka shkruar Tahiri në “Facebook”.

Banka Botërore: Kosova do ta ketë rritjen më të madhe të GDP-së në rajon gjatë viteve 2024 dhe 2025

Prishtinë, 14 janar - Banka Botërore ka publikuar parashikimet e saj për rritjen e Bruto Produktit Vendor (GDP) për gjashtë vendet e Ballkanit

Perëndimor për vitet 2024 dhe 2025. Sipas Bankës Botërore, Kosova do të jetë vendi me rritjen më të madhe të GDP në vitin 2024 me 3,9 për qind,

kurse në vitin 2025, 4 për qind. Pas Kosovës në parashikimet e Bankës Botërore radhiten Serbia, Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia Veriore.

Ndërsa rritjen e më të ulët të GDP-së, krahasuar me vitin 2023 gjatë dy viteve të ardhshme, pritet ta kenë Shqipëria dhe Mali i Zi.



Kukullat mizore të Iranit

Për herë të dytë në më pak se tre vjet, Kanali i Suezit bëhet i pakalueshëm, duke vënë në krizë trafikun ndërkombëtar dhe tregtinë botërore. Në gjysmën e dytë të marsit 2021, kur bota po rikthehej me mundim nga kriza e pandemisë Covid 19, një stuhi me erë dhe rërë shkaktoi kalimin e një anijeje gjigante mallrash, Ever Given, duke bllokuar lundrimin për disa ditë dhe duke shkaktuar rritjen në qiell të çmimeve, nga nafta e papërpunuar te perimet. Sot papërdorshmëria e një kalimi strategjik, që përshkohet çdo vit nga 22,000 anije, 30 për qind e trafikut detar ndërkombëtar dhe 15 për qind e tregtisë botërore, nuk shkaktohet nga forcat e natyrës dhe ngarkesa e tepërt e një anijeje tregtare, por nga rreziku i sulmeve tëHouti-ve, të quajtur ndryshe Partizanët e Allahut, rebelët jemenitë të armatosur dhe financiar nga Irani, të cilët që nga 9 nëntori i vitit që kaloi, kur shtinë në dorë anijen e mallrave Galaxy Leader,

me një zbarkim spektakolar duke zbritur prej helikopterëve, kanë kryer plot 27 aksione kundër anijeve që kalojnë tranzit nga Gjiri i Bab al Mandab. Efektet e menjëhershme janë të njëjtët. Reduktim i trafikut detar: 91 përqind për kontenierë, nga dje edhe shoqata ndërkombëtare e pronarëve të anijeve të naftës këshillon anëtarët e vet që të qëndrojnë larg nga Bab al Mandab, kompanitë e mëdha të kontenierëve si Maersk dhe Msc, që të marrin në konsideratë rrugën e Kepit të Shpresës së Mirë, 10 ditë më e gjatë se sa ajo e Suezit. Çmimet janë rritur menjëherë, duke nisur nga ata të naftës brut (4% në vetëm një ditë), e deri tek çmimet e furnizimeve ushqimore. Por kësaj radhe, steka është shumë më lart dhe me rrezik se sa ajo e ngjarjeve të paparashikueshme natyrore. Dhe rreziku mund të jetë më afatgjatë se sa një stuhi rëre. Bëhet fjalë për të drejtën universale të lirisë së lundrimit

dhe kundërvënies ndaj piraterisë, që është maskuar prapa mbështetjes për “kauzën palestineze”, për ofensivën izraelite në Gaza. Në të vërtetë, Houti-tëve as nuk u bëhet vonë për palestinezët. Atyre u duhet vetëm si një argument më shumë për negociata, që ta hedhin në tryezën e bisedimeve të paqes me Arabinë Saudite, të cilat nisën pas armëpushimit të brishtë të vitit 2022. Siç ka thënë një ekspert i Chatham House, instituti autoritar londinez, Houti-t janë “biznesmenë ushtarakë shumë të zotë”, që janë duke kapitalizuar shansin që u ka dhënë ofensiva izraelite, e cila pasoi masakrën e tmerrshme të Hamasit në 7 tetor: “Mbrojnë Palestinën, sulmojnë Izraelin, denoncojnë hipokrizinë e vendeve të tjera arabe. Prandaj, sa kohë që lufta në Gaza do të vazhdojë, Houti-t do të vazhdojnë përshkallëzimin në Detin e Kuq”. Pikërisht për të shmangur këtë “përshkallëzim”, përveçse për të

rikthyer të drejtën e lirisë së lundrimit, SHBA dhe Britania e Madhe kanë vendosur një sulm masiv ndaj bazave të Houti-tëve në Jemen, të mbështetur nga një koalicion heterogjen, i përbërë nga Kanadaja, Australia, Bahreini dhe Holanda, e vetmja anëtare nga vendet evropiane. Ndoshta sepse parimi i lirisë së deteve është i rrënjosur në kujtesën e një populli lundruesish dhe të një vendi, i cili ka qenë një fuqi e madhe detare: në vitet e tyre të artë, rreth viteve 1670, Kompania e Indive kishte 150 anije detare dhe 40 anije lufte. Houti-t kishin qenë nënvlërësuar, sikur të ishin një formacion i vogël dhe më pak i rrezikshëm, të paktën në optikën perëndimore, në “boshtin e rezistencës” shiite, të drejtuar nga iranianët, përbërë nga Hamasi, Hezbollahu dhe Xhihadi Islamik. Në të vërtetë kanë zhvilluar një aftësi ushtarake të madhe, e cila ka ardhur duke u rritur bashkë me ekspansionin e tyre territorial

në Jemen dhe me shpenzimet e forcave qeveritare, duke zëvendësuar armatimet e vjetra sovjetike me instrumenta lufte moderne: nga raketat tek dronët, të cilat i ekspozuan vitin e kaluar në një paradë të madhe ushtarake në kryeqytetin Sana’a, bashkë me sloganin “Vdekje Amerikës, vdekje Izraelit”. Dhe besueshmëria e tyre politike është rritur falë mistifikimit me zotësi që i kanë bërë mbështetjes së “kauzës palestineze”. Rreziku i një zgjerimi të konfliktit përballë një reagimi të fortë anglo-amerikan është real, edhe pse kukullat iraniane të “boshtit të rezistencës” duken shumë të kujdesshme dhe selektive në lëvizjen e fijeve, në morsën që duan të shtrëngojnë përreth izraelit. Por pasojat e një ndërprerjeje të tregtisë botërore do të ishin shumë më të rënda nëse do u lejohej Houti-tëve që të vazhdojnë piraterinë, me justifikimin e një “kauze të drejtë”. | (Paolo Garimberti, *La Repubblica*) (bota.al)



‘Lufta mund të vijë edhe tek ne’: synimet e Rusisë dhe hija mbi NATO-n

Qeveria suedeze ngre alarmin për shpërthimin e mundshëm të një konflikti me Rusinë dhe përgatit një plan ushtarak në prag të anëtarësimit në NATO




Tensioni po rritet në Evropën Veriore dhe më gjerë, pas fjalëve të ministrit suedez të Mbrojtjes Civile Carl-Oskar Bohlin, i cili ftoi popullatën të përgatitet për më të keqen. “Shumë njerëz e kanë thënë tashmë para meje, por më lejoni ta them më fort: mund të ketë një luftë në Suedi,” tha zyrtari sot, në një konferencë vjetore në qytetin e Sälén. Alarmi, i ngritur së fundmi edhe në Gjermaninë fqinje, vjen nga klima e pasigurisë e lidhur me reduktimin e ndihmës ushtarake për Kievin dhe zgjedhjet presidenciale amerikane, të cilat mund të çojnë në kthimin në Shtëpinë e Bardhë të izolacionistit

Donald Trump. “Për një vend që ka qenë në paqe për të paktën 210 vjet, ekziston një sugjestionim sikur kjo është një gjendje e pandryshueshme. Por zhytja në këtë rehati përbën një rrezik pothuajse të paprecedentë, “tha Bohlin. Pak ka vlejtur sqarimi i ministrit, se ai nuk ka ndërmend të futë vendin në panik, por përkundrazi dëshiron të krijojë një “ndërgjegjësim” kolektiv për realitetin e ri gjeopolitik evropian, pak më pak se dy vjet pas fillimit të konfliktit në Ukrainë. Efektet e shkaktuara nga “mjellma e zezë” në këtë rajon të Kontinentit të Vjetër

kanë qenë të thella. Suedia dhe Finlanda paraqitën menjëherë një kërkesë zyrtare për t’u anëtarësuar në NATO. Një rrugë e kryer nga Helsinki, e cila duket më e vështirë për Stokholmin, veçanërisht për shkak të rezervave të shprehura nga presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan. Edhe ministri suedez i Mbrojtjes Pål Jonson përsëriti mesazhin e kolegut të tij qeveritar, duke folur për një botë “më të rrezikshme se një vit më parë”, për shkak të konflikteve në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme. “Ne nuk mund të përjashtojmë një sulm të armatosur kundër Suedisë. Lufta mund të vijë tek

ne”. Ky është paralajmërimi i errët i Jonson, i cili paralajmëron kundër dëshirës së presidentit rus Vladimir Putin për të rikrijuar zonat e ndikimit dhe për të rivendosur një politikë të bazuar në përdorimin e armëve për të çuar përpara interesat e Kremlinit. Përfaqësuesi i Mbrojtjes së Stokholmit parashikoi gjithashtu prezantimin e një plani që synon arritjen e katër objektivave për të maksimizuar rolin e Suedisë në funksion të hyrjes së saj të ardhshme në Aleancën Atlantike: forcimi i ushtrisë përmes rekrutimeve dhe profesionistëve, siguri i një

sistemi afatgjatë furnizimi me municione brenda zonës skandinave për të reduktuar kohën e pritjes për dërgesat, për një strategji inovative mbrojtëse për të arritur epërsinë teknologjike në fushën e betejës dhe për të zgjeruar shpejt sistemin e sigorisë, duke krijuar një “mbrojtje të bazuar në rritje”. Deklaratat e ministrave u shoqëruanga angazhimi i komunikuar prej kryeministrit suedez Ulf Kristersson i cili njoftoi vendosjen e ardhshme të një batalioni të forcave të armatosura në Letoni, për të “kontribuar në mbrojtjen dhe parandalimin e në kuadër të NATO-s”. (bota.al)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Reali rrëmben Superkupën e Spanjës për herë të 13-të

RIYADH, 14 JANAR - Real Madrid fitoi Supërkupën e Spanjës për herë të 13-të në histori. Një spektakël unik në KSU Stadium (Riyadh), aq më tepër në një “El Clasico”, një takim ku “Los Blancos” triumfuan 4-1 ndaj Barcelonës. Vinicius Junior tregoi klasin e tij që në 10 minutat e para të ndeshjes. Ylli brazilian realizoi dopietë, duke dërguar në

festë tifozët madrilen. Ekipi i Xavit i rifut në lojë në minutë ne 33-të. Lewandowski, me një gjuajtje fluturimthi, ia doli të mposhtë portierin Lunin. I jashtëzakonshëm Vinicius, i cili kompletoi tripletën brenda pjesës së parë. Në pjesën e dytë, në të 64-tën, Rodrygo i dha goditjen e fundit katalanasve. Barça mbylli ndeshjen me një lojtar më pak, pas daljes

me karton të kuq të Araujo (71’). Kështu, Real Madrid festoi në fund Superkupën e 13-të, pas atyre të viteve 1988, 1989, 1990, 1993, 1997, 2001, 2003, 2008, 2012, 2017, 2020 dhe 2022. Barcelona vazhdon me rekordin negativ, dështon të mbrojë trofeun, diçka që nuk ndodh që nga 2010/2011 kur trajneri Pep Guardiola ishte në krye të ekipit.



Fitore e rëndësishme për Vëllaznimin, fiton edhe Bashkimi

GIKOVË, 14 JANAR - Vëllaznimi ka shënuar fitore shumë të rëndësishme, duke mundur Proton Cable Prizrenin 86:70 (22:21, 20:13, 26:19, 18:17), në javën e 17-të të Prince Caffë Superligës. Sfida nga fillimi ishte interesante, ku mysafirët e nisën 2:6, por u kundërpërgjigjën vendasit, duke kaluar në epërsi 22:17, sidoqoftë, çereku i parë përfundon 22:21. Kuqezinjtë ishin më të mirë në periudhën e dytë, ku kishin epërsi deri në nëntë pikë, 40:31, derisa pjesa e parë përfundoi 42:34. Kuqezinjtë vazhduan me lojë të mirë dhe në periodën e tretë, ngritën epërsinë në 17 pikë, 68:51, kurse shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 68:53. Prizrenasit në dhjetë minutat e fundit afruan shifrat në 68:60, por pa arritur të bëjnë më shumë dhe Vëllaznimi ngriti epërsinë për të triumfuar në fund 86:70. Më i miri te Vëllaznimi ishte

Sammuel Sessoms me 23 pikë, nëntë kërcime e nëntë asistime, kurse te Proton Cable Prizreni, Desi Sills kishte 16 pikë e pesë asistime dhe Arti Hajdari 13 pikë e gjashtë kërcime. Tani Vëllaznimi numëron tetë fitore e nëntë humbje, kurse Proton Cable Prizreni pesë fitore e 12 humbje. Bashkimi mundi Istogun në Prizren me rezultat 73:90 (28:27, 20:22, 3:22, 22:19), në javën e 17-të të Prince Caffë Superligës, ku periudha e tretë ishte vendimtare. Çereku i parë i ndeshjes ishte i barabartë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte të shpëputej, duke përfunduar 28:27, derisa në periudhën e dytë, istogasit kaluan në epërsi prej nëntë pikësh, 44:35, por prizrenasit arritën të kthehen shpejt, duke shkuar në pushim me shifrat 48:49. Perioda e tretë ishte vendimtare, pasi Istogu shënoi vetëm tri pikë për dhjetë minuta karshi 22 të



prizrenasve, duke e bërë dallimin e madh në këtë ndeshje dhe Bashkimi triumfoi 73:90. Arian Azemi ishte më i

miri te istogasit me 23 pikë, kurse te prizrenasit më i miri ishte Lejson Zeqiri me 24 pikë e 12 kërcime. Istogu mbetet në

vendin e fundit me një fitore e 16 humbje, kurse Bashkimi është në vendin e gjashtë me gjashtë fitore e 11 humbje.

Milani mposhti Romën në ‘San Siro’



MILANO, 14 JANAR - Milani ka shënuar fitore ndaj Romës me rezultat 3-1 në kuadër të javës së 20-të, ku tre golat për kuqezinjtë erdhën nga lojtarët francezë. Kuqezinjtë edhe pse kanë mbetur prapa, tani nëntë pikë larg Interit, nuk e kanë ndërmend të dorëzohen, pasi vetëm tani ka filluar faza e dytë e kampionatit. Me të filluar

takimi, Yacine Adli përfitoi nga një asistim i Tijjani Reijnders për të shënuar për 1-0. Roma kishte raste për të barazuar në pjesën e parë, por edhe përkundër tyre nuk ia doli. Në fillimin e pjesës së dytë, Olivier Giroud shënoi me një goditje me kokë për 2-0. Roma fitoi penallti, ku nga pika e bardhë ishte i saktë Leandro Paredes, duke e

mposhtur Mike Maignan për 2-1, duke u menduar se u hap ndeshja. Por dilemat e fituesit i shoi, Theo Hernandez që shënoi për 3-1, pas asistimit të Giroud. Milani me këtë fitore mbetet i treti me 42 pikë, katër më pak se Juventsi dhe nëntë më pak se Interi. Roma në anën tjetër mbetet në vendin e nëntë me 29 pikë.

Kosova në fazën kryesore kualifikuese për ‘Euro 2026’

PRISHTINË, 14 JANAR - Ashtu si pritej, Përfaqesuesja e Kosovës në hendboll e ka fituar edhe ndeshjen e dytë ndaj Britanisë së Madhe. Të shtunën në Derby të

Anglisë, Kombëtarja jonë fitoi me rezultat 29:23. Kështu Kosova e kalon raundin promovues të kualifikimeve për “Euro 2026” dhe do të paraqitet

në kualifikimet e rregullta. Kosova ishte në epërsi nga fillimi e deri në fund, ndërsa ndeshja u zhvillua në atmosferë shumë të bukur në praninë e 1500

shikuesve. Kosova kishte fituar bindshëm edhe të mërkurën në Prishtinë dhe tani i pret kundërshtarët e fazës kryesore kualifikuese.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Africa Balkans Trade And Culture Centre" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues 811896911.

- Gëzim Kollçaku shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit Juridik të UP-së, Prishtinë.

- Leutrim Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Elvira Gojani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomë e sh.m. Mjekësisë “ Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Astrit Jusufi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Bledar Topalli nga Gjakova shpall
të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III,
IV dhe diplomën e sh.m. Teknike
“Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)





TRADITË QË NGA 1992

